

PICASSO CLASSIC VN-35 ULTRA WHITE



PËRSHKRIMI

Bojë plastike e një cilësie premium e prodhuar me teknologjinë më të avancuar "One Coat" me rezistencë të lartë ndaj larjes së vazhdueshme dhe veti superiore mbuluese me bazë emulSIONI PVA-VEOVA

KARAKTERISTIKAT E PRODUKTIT

- Bardhësi e vezulluese
- Mbulueshmëri superiore
- Sipërfaqe e lëmuar mat
- Gjendet vetëm në bazën W
- Ngjitje e fortë dhe tharje e shpejtë
- Rezistencë të lartë ndaj larjeve të shpeshta
- Karakteristika shumë të mira punimi dhe nivelimi
- Pranon 7000 cikle larjesh pas 30 ditësh nga aplikimi

PËRDORIME TË REKOMANDUARA

Përdoret në të gjithë muret dhe tavanët e brendshëm, të rinj, të vjetër dhe të lyer më parë me bojë, me bazë çimento, gëlqere, gips, dhe në çdo lloj ambienti të brendshëm, dhoma gjumi, tualete, dhoma ndenjjeje, ambiente zyrrash, shërbimesh etj.

KARAKTERISTIKA TEKNIKE

Rezina	PVA VEOVA Polimer
Densiteti EN ISO 2811-1	1,45±0,02 gr/ml
Mbetja e thatë EN ISO 3251	65%
Shkalla e hollimit	10 – 15%
Viskoziteti	110 ± 5 KU
Koha e tharjes mes dy shtresave	2 - 4 orë
VOC në produktin e gatshëm (Di rektiva Europiane 2004/42/EC) (g/l)	≤ 10
VOC emetimi në ambient, dhomë simulimi ISO 16000 (mg/m3)	≤ 0.2
Aftësia mbuluese EN ISO 6504-3	≥ 99.5% Klasa I
Rezistenca ndaj larjes ISO 11998	Klasa I

UDHËZIME APLIKIMI

- Metoda e aplikimit: Furçë, rrul ose me sprucim.
- Hollimi: Rekomandohet të hollohet me 10-15% ujë.

PËRGATITJA E SIPËRFAQES

Sipërfaqet duhet të jenë të thara plotësisht, të pastra dhe pa elemente që pengojnë ngjitshmërinë e bojës. Riparoni të gjitha plasaritjet dhe pjesët e dëmtuara duke përdorur produktet e linjës Deutschcolor, Vox 707, Glatte Spachtel, Spachtel Finish etj. Më pas rekomandohet të aplikohet astar Macht Tiefgrund Wasser, i holluar me ujë në raportin 1:1 ose astar Macht Haftgrund i holluar me ujë në raportin 1:3. Gjatë aplikimit të astarit evitoni krijimin e një cipe e cila më pas krijon probleme në lidhjen e bojës me suportin.

PAKETIMI

3 lt, 10 lt

RUAJTJA

36 muaj nëse ruhet në një vend të thatë, larg burimeve të nxehtësisë, në një temperaturë midis +5°C dhe +30°C. Mbrojeni nga ngrica.

INFORMACIONI MBI SHËNDETIN, SIGURINË DHE MJEDISIN

Mbajeni larg fëmijëve produktin. Nëqoftëse gjelltitet lajmëroni dhe kërkoni ndihmën e mjekut dhe tregojini atij përmbajtjen e ambalazhit. Mos e hidhni produktin në tubacione ose kanale.

SHËNIME

- Rekomandohet që sipërfaqet e lyera të mos lahen deri sa të kalojnë 30 ditë nga aplikimi.
- Në sipërfaqet e freskëta të betonit produkti rekomand të aplikohet të paktën pas 30-40 ditësh.

